

VENDIM
Nr. 796, datë 23.12.2024

PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL PËR NEGOCIIMIN DHE NËNSHKRIMIN E KONTRATËS PËR REALIZIMIN E TRI TUREVE TË PARA TË “GIRO D’ITALIA 2025”, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRDORIMIN E FONDEVE, SI DHE MËNYRËN E PAGESËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 13, të nenit 11, të ligjit nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL DHE DETYRAT E TIJ

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional që do të kryejë negociimin e kontratës me subjektin “RCS Sport” s.p.a / “RCS Sports & Events” s.r.l, si subjekti që ka ekskluzivitetin e organizimit të eventit sportiv “Giro d’Italia”, me qëllim zhvillimin e tri tureve të para të “Giro d’Italia 2025”, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Grupi ndërinstitucional kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe ka në përbërje të tij anëtarë të nivelit të lartë drejtues, përfaqësues nga:

- a) Ministria përgjegjëse për punët e brendshme;
- b) Ministria përgjegjëse për turizmin;
- c) Ministria përgjegjëse për kulturën;
- ç) Ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
- d) Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

3. Grupi ndërinstitucional ngarkohet:

a) të kryejë bisedimet-negociatat me subjektin “RCS Sport” s.p.a / “RCS Sports & Events” s.r.l, me qëllim arritjen e marrëveshjes për zhvillimin e tri tureve të para të “Giro d’Italia 2025”, në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) të paraqesë raportin final në përfundim të negociatave dhe projektkontratën e dakordësuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

4. Bazuar në raportin final të negociatave dhe të projektkontratës përkatëse të dakordësuar, nënshkruhet kontrata me subjektin “RCS Sport” s.p.a / “RCS Sports & Events” s.r.l, nga kryetari i grupit ndërinstitucional.

II. MËNYRA E PËRDORIMIT TË FONDEVE

1. Pas nënshkrimit të kontratës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëse nuk disponon fonde të mjaftueshme buxhetore për përballimin e shpenzimeve për detyrimet e kontratës, i kërkon ministrisë përgjegjëse për financat marrjen e masave në funksion të kalimit të fondeve të nevojshme në buxhetin e saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

2. Pas lidhjes së kontratës, çdo pagesë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kundrejt subjektit “RCS Sport” s.p.a / “RCS Sports & Events” s.r.l, bëhet pas paraqitjes së kërkesës së këtij të fundit dhe në përputhje me parashikimet e kontratës, përfshirë edhe pagesën e tarifës së pjesëmarrjes (*fee*), në rast parashikimi në kontratë.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit autorizon kryerjen e pagesës pas dorëzimit nga subjekti “RCS Sport” s.p.a / “RCS Sports & Events” s.r.l, të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) Kërkesës për pagesë;
- b) Faturës së lëshuar nga subjekti kontraktor, sipas rregullave në fuqi në vendin e regjistrimit si person juridik;
- c) Në rast se në kontratë do të parashikohet tarifë pjesëmarrjeje (*fee*), Ministria e Arsimit dhe Sportit kryen pagesën bazuar në faturën e lëshuar, sipas përcaktimeve në kontratë për vlerën e tarifës së pjesëmarrjes (*fee*).

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet kompetencat e të cilëve lidhen me kryerjen e tri tureve të para të “*Giro d'Italia 2025*”, në territorin e Republikës së Shqipërisë për të marrë masat për realizimin e detyrimeve të palës shqiptare në kontratën që do të nënshkruhet, në përputhje me fushën e tyre të përgjegjësisë shtetërore.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama